



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim B-A (2)

Ngarkesa: 6kredite;20 leksione, 40 seminare;60orë gjithsej

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I , Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të japë parimet themelore në përkthimin e teksteve të specialitetit duke theksuar dallimin mes përkthimit pragmatik dhe atij teknik, si dhe të shpjegojë dhe analizojë teknikat dhe strategjitë e përkthimit teknik. Të aftësojë studentët në analizën e një teksti të specialitetit nëpërmjet punës me termat e fushës dhe përcaktimit të strategjive të përkthimit, duke bërë të mundur më pas që të shprehin kuptimin në gjuhën mbërritëse në përputhje me rregullat sintaksore dhe terminologjike të kësaj të fundit (teknikat e përkthimit, rishkrimin e tekstit, rishikimin e tij, si edhe terminologjinë përkatëse në shqipe) dhe të reflektojnë në lidhje me strategjitë e përkthimit terminologjik nga gjuha B në A.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të njohë se si :

- të analizojë një tekst;
- të punojë me termat e fushës;
- të hartojë strategjitë e përkthimit;
- të shprehë kuptimin në gjuhën mbërritëse në përputhje me rregullat sintaksore dhe terminologjike të kësaj të fundit (teknikat e përkthimit, rishkrimin e tekstit, rishikimin e tij, si edhe terminologjinë përkatëse në frengjisht) dhe të reflektojnë në lidhje me strategjitë e përkthimit terminologjik në gjuhën B.

Rezultate të pritshme:

- Aftësimi i studentëve për të përdorur burime të ndryshme dhe efikase informacioni në lidhje me temën e trajtuar në tekst.
- Aftësimi i studentëve për të mobilizuar kompetencat dygjuhësore dhe tematike.
- Aftësimi i studentëve për analizën e tekstit dhe evidentimin e problemeve terminologjike.
- Aftësimi i studentëve për të përdorur mjete të ndryshme që i vijnë në ndihmë përkthyesit në kuptimin dhe gjetjen e strategjive përkthimore (fjalorë të ndryshëm dygjuhësh dhe terminologjikë, motorë kërkimi, programe të ndryshme kompjuteri, etj.).
- Aftësimi i studentëve për kërkime terminologjike.
- Përvetësimi i terminologjisë së fushave të ndryshme dhe gjetja e strategjive përkthimore.